



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 25.01.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
2. Rasim Hasani, DKA
3. Shkelzen Hajdini, DSHPS
4. Latif Ramadani, DBF
5. Burim Rrustemi, DSHPMM
6. Valon Pacolli DEZH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar Dhjetor 2023
3. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social
4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit
5. Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2023-2027
6. Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)

Pastaj tha do ta keni edhe një pike shtese me propozim te ekzekutivit

8. Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15 nr.353/01-69530 i datës 21.12.2023 caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikës shtese dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 22-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

Raporti e a jeni i pajtimit qe te shkoj direkt ne Kuvend.

Me te gjitha votat prezentë kaloi direkt për kuvend

III

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit , nga DSHPS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha e mbështesim këtë propozim vendim por do te ishte mire qe komisioni i cili i mbikëqyr këta përfitues te shikoj mundësinë qe ketë te bëjnë ndonjë pune për te mirën e komunitetit

Shkelzen Hajdini, tha se ideja eshët e mire do ta shohim se si është e përcaktuar me legjislacion.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se këshillat e fshatrave janë shume te nevojshëm dhe bëjnë një pune shume te mire, po do te ishte mire qe te kenë një page edhe do te merreshin me nevojat e vendbanimit. Dhe qysh e di unë ne bazë te rregullores këta paguhet 50 euro për mbledhje qe i kanë 6 mbledhje ne vit.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se neve nuk po na lejon ministria me i paguar këta kryetar te cilët disa prej tyre kane mbajt nga 6 takime e disa me pak por nuk po na lejohet me i paguar, tani po mundohemi ne këtë mënyre sado pak me ju ndihmua. Sepse ne nuk po mundemi as komisionet me i paguar e as KKSBB-ne qe janë obligative, se s'po na lejon ministria.

Arsim Jashari, tha se ligji për vetëqeverisje Lokale shumë mire e ka caktuar qe duhet te paguhet por nuk e di çka o ka ndodh kështu me këta.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqi nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha pse nuk është e përfshimë edhe komuna e Drenasit në këtë Marrëveshje.

Egzona Bytyqi, tha se është mirë qe te ketë ndonjë iniciative për marrëveshje me komunën e Drenasit pasi qe mund te jete dhe ne interesin tone si komunë.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se komuna e Drenasit nuk ka dashtë te jetë pjese e kësaj marrëveshje. Ndërsa nëse e shohim te nevojshme ne mund te nënshkruajmë ndonjë marrëveshje me Drenasin apo me ndonjë komune tjetër.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15 nr.353/01-69530 i datës 21.12.2023 caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit nga DKA e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha a po i bijën që do të kthehen në pikën zero pasi as unë nuk po e kuptoj çka ka dashtë me thënë me këtë Ministria

Rasim Hasani, tha se po do të kthehet në pikën zero dhe as në nuk po e dimë çka ka dashtë me thënë me këtë Ministria

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit nga DESH e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2023-2027

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit nga DSHPMM e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha a do jenë vitin 2023-2027 apo duhet ne ndryshohet te behet 2024-2027 pasi qe tani jemi ne vitin 2024. Dhe statistikat et cilat i keni në plan a janë te sakta a e keni kontrolluar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se eshtë mire se bashku me zyrën ligjore me shikuar se si duhet te jete vitin 2023 apo 2024 si dhe te shikohen edhe çështjet tjera.

Burim Rustemi, tha se do ta shikojmë dhe nesër ne kuvend do ta sqarojmë.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:15

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi